



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1158/2 Prot.

Tiranë, më 19.08.2024

**V E N D I M**

**Nr. 228, Datë 19.08.2024**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”<sup>1</sup>, të ndryshuar, shqyrtoi ankesën nr. 160, datë 08.08.2024, të paraqitur nga shoqata “*Shoqata për Miqësi Bullgaro-Shqiptare*”, kundër z. E.Th, ish Kryetar i Bashkisë Pustec dhe njëkohësisht përfaqësues i Shoqatës “Prespa”, në të cilën pretendohet për përdorim të gjuhës së urrejtjes, për shkak të etnisë, kundrejt pakicës kombëtare Bullgare në Shqipëri.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “*Shoqata për Miqësi Bullgaro-Shqiptare, është një organizatë e themeluar me datë 11.11.2015, me vendimin nr. 5191/2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objektiv zhvillimin kulturor, arsimor, si dhe ruajtjen e identitetit kombëtar të pakicës bullgare në Shqipëri.*

*Si pjesëtarë të komunitetit bullgar, dëshirojmë të shprehim shqetësimin tonë të thellë në lidhje me disa raste të dukshme të diskriminimit në bazë të gjuhës së urrejtjes dhe mohimit të*

<sup>1</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri ose KMD.

*ekzistencës së minoritetit tonë në Shqipëri, nga ana e përfaqësuesve të minoritetit Maqedonas në Shqipëri dhe përfaqësuesit e Shoqatës Prespa.*

*Në datën 03.07.2024, në një intervistë për median Alfa Tv, të Maqedonisë së Veriut, z. E.Th, ish Kryetar i Bashkisë Pustec dhe njëkohësisht përfaqësues i Shoqatës Prespa, ka shfaqur sjellje diskriminuese, duke përdorur gjuhë të papërshtatshme dhe ofenduese ndaj komunitetit tonë bullgar. Ai ka shpërndarë deklarata që mohojnë ekzistencën tonë dhe krijojnë një imazh negativ dhe stereotipe të padrejta rreth identitetit tonë etnik.”*

Subjekti ankues ka bashkëlidhur ankesës, në cilësi prove, kopjen e linkut ku mund të aksesohet emisioni në fjalë: <https://youtube/bc9HvUzsLo0>

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi: *“Hetimin e rastit për përdorim të gjuhës së urrejtjes. Mospërsëritje të gjuhës së urrejtjes, kërkimin e faljes publike, dhe vendosje të gjobës”.*

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja b), të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “etnisë”, duke përcaktuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Neni 7, i LMD-së, parashikon shprehimisht: *“1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara*

*nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”*

“Shoqata për Miqësi Bullgaro-Shqiptare”, është një organizatë jofitimpurëse, regjistruar si person juridik, me vendimin nr. 5191, datë 11.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, shoqata ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së saj mbrojtjen e interesave të anëtarëve të saj të pakicës kombëtare bullgare në Shqipëri.

Pala ankuese pretendon për diskriminim të të gjithë anëtarëve të saj, pjesë e pakicës kombëtare bullgare në Shqipëri, nëpërmjet përdorimit të gjuhës së urrejtjes nga ana e ish Kryetarit të Bashkisë Pustec dhe përfaqësuesit të Shoqatës Prespa, z. E.Th, në intervistën e dhënë në televizionin Alfa Tv, të Maqedonisë së Veriut.

Bazuar në LMD, pala ankuese/Shoqata për Miqësi Bullgaro-Shqiptare, në cilësinë e personit juridik, është subjekt i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe legjitimohet për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Për sa më lart, lidhur me pretendimin për diskriminim përmes gjuhës së përdorur nga e z. E.Th/ish Kryetar i Bashkisë Pustec dhe përfaqësues i Shoqatës Prespa, subjekti ankues, i referohet intervistës së tij, dhënë për median Alfa Tv, të Maqedonisë së Veriut, në datën 03.07.2024.

Lidhur me verifikimin e përmbajtjes së bisedës së zhvilluar në intervistën në fjalë, Komisioneri iu referua transmetimit të emisionit në fjalë, të cilin e aksesoi në linkun e dërguar nga pala ankuese:

<https://youtube/bc9HvUzsLo0>

Nga këqyrja e sa më sipër, Komisioneri vëren se:

Së pari, intervista e dhënë nga z. E.Th për median e Alfa Tv, të Maqedonisë së Veriut, është në gjuhën maqedonase, nuk është në gjuhën shqipe dhe për pasojë, përmbajtja e bisedës së zhvilluar në këtë intervistë, nuk është e kuptueshme nga ana e KMD-së. Për rrjedhojë dhe analizimi i gjuhës së përdorur nga z. E.Th gjatë intervistës.

Së dyti, edhe nëse do të përkthehej biseda gjatë intervistës në fjalë, Komisioneri vëren se, shqyrtimi e analizimi i gjuhës së përdorur nga ana e z. E.Th gjatë saj, nuk mund t’i nënshtrohet shqyrtimit administrativ të KMD-së, në kontekst të pretendimit të palës ankuese për përdorim të gjuhës së urrejtjes, pasi është jashtë kompetencës së Tij, bazuar në sa më poshtë vijon:

- Veprimet e z. E.Th, pra gjuha e përdorur prej tij, (pa analizuar nëse ajo në vetvete ka apo jo elementë të gjuhës së urrejtjes me shkak etnik, kundrejt pakicës kombëtare bullgare në Shqipëri), lidhet me intervistën e tij dhënë një televizioni të huaj, Alfa Tv, i cili zhvillon

veprimtarinë e tij dhe është subjekt juridik i ndodhur në territorin e Maqedonisë së Veriut. Për pasojë, kjo media, Alfa Tv e Maqedonisë së Veriut, e cila ushtron veprimtarinë e saj në territorin e shtetit të Maqedonisë së Veriut dhe i drejtohet audiencës së shtetasve të vet, nuk është subjekt i cili i nënshtrohet kontrollit të autoriteteve të shtetit shqiptar, e as legjislacionit tonë të brendshëm kombëtar. Për rrjedhojë, veprimtaria e kësaj media (intervistës së dhënë në dhe për llogari të saj nga ana e z. E.Th) nuk i nënshtrohet as kontrollit të KMD-së e as ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

- KMD, nuk legjitimohet të kërkojë nga ana e kësaj media televizive të huaj, as informacion, as të pajiset me kopje autentike<sup>3</sup> të intervistës dhe as të njihet me qëndrimin e saj lidhur me pretendimet e palës ankuese, e aq më tepër të hetojë e të shprehet lidhur me sa pretendohet nga pala ankuese.

Neni 4, i LMD-së, përcakton qartë se cilat janë subjektet që i nënshtrohen zbatimit të tij, si vijon: “1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. 2. Shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare. 3. Personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare”.

Pra, bazuar në sa më sipër, qartazi, subjekteve të përfshira në nenin 4, të LMD-së, u garantohet mbrojtje e ofruar nga ky ligj, *vetëm* në raport e në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare. Për rrjedhojë, hetimi administrativ për shqyrtimin e këtij rasti, lidhur me pretendimin për përdorim të gjuhës së urrejtjes nga z. E.Th, të konsumuar në intervistën e dhënë në median televizive maqedonase, Alfa Tv, Maqedonia e Veriut, (jashtë territorit shqiptar) nuk mund të vijojë, për shkak të mungesës së kompetencës territoriale dhe lëndore të KMD-së.

Komisioneri vëren se, pala ankuese pretendimin për përdorimin e gjuhës së urrejtjes, transmetuar nëpërmjet televizionit maqedonas Alfa Tv, mund ta ngrejë në organet kompetente që ushtrojnë kontroll në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Maqedonisë së Veriut, apo pranë organeve kompetente të drejtësisë në Maqedoninë e Veriut.

Në këtë kontekst, bazuar në sa më lart, Komisioneri nuk ka tagër e kompetencë ligjore për hetimin, shqyrtimin e vlerësimin e pretendimeve të palës ankuese. Për rrjedhojë dhe shqyrtimi i tyre është jashtë kompetencave të KMD-së, dhe për pasojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

<sup>3</sup> Si i vetmi burim legjitim që e posedon atë dhe gëzon të drejtën e tagrin për lëshimin e certifikimit e origjinalitetit të saj.

Në nenin 33, pika 4/b, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) .....është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.”*. Mungesa e kompetencës së Komisionerit për shqyrtimin e këtyre pretendimeve të paraqitura nga pala ankuese, e bën ankesën lidhur me këto kërtime, të papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/b, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b, të ligjit nr.10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Mospranimin e ankesës me nr. 160 Regj., datë 08.08.2024, të subjektit ankues “Shoqatës për Miqësi Bullgaro-Shqiptare”, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**